

Data 08/04/2026

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Investime për transformimin e aseteve publike me potencial zhvillimi në modele të standardit më të lartë të zhvillimit: “Përforcimi i godinës së shtëpisë së fëmijës “Vangjel Pulla”, Sarandë”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 53,867,793.17 Lekë pa TVSH. Programi buxhetor IVR , 24AF701.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. **Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2023,2024,2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlogaritur e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të lartë monetar dhe të ulët monetar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.“

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024, 2025 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika "b", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislativës të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në*

atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii.ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

- a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose
- b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtarë i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarjes
- Fature tatimore e situacionit përfunditar të deklaruar në organet tatimore
- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufiri të ulët dhe të lartë monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për

kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve.

PER PUNIMET E PERGJITHSHME TE NDERTIMIT

- NP 1 A Punime gjurmimi në tokë.
 NP 3 B Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.

PER PUNIMET SPECIALE TE NDERTIMIT

- NS 1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
 NS 4 A Punime rifiniture të muraturës dhe punimeve të lidhura me ato.
 NS 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
 NS 9 A Punime strukturorë speciale.
 NS 18 A Punime topogjeodezike

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, (ose Ministrisë kompetente të kohës) Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM- në, Nr.42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues.

ARGUMENTIMI LICENCAT

Kerkesa e mesiperme është percaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për -prokurimin publik", nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar si dhe Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", i ndryshuar. Të dhënat për licencat e mesiperme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" të ndryshuar, nëni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridike, private ose publike, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane.

Kategoritë janë kërkuar bazuar në zerat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit sipas kategorisë përkatëse	Vlera e punimeve, sipas kategorisë përkatëse
NP 1 A	Punime gjurmimi në tokë.	Gjurmim e mbushje dheu me krah kat IV për themele, h=1.5m Transport materiale ndërtimi, dheu me auto deri 10.0 km	0-20 milion lekë	1,114,402

NP 3	B	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.	Nenshtrese zhavori Shtrese llaç-çimento t=8cm Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cimento. Pergatitur nga dy komponente A+B F.V. Tuba te brinjezuar HDPE SN8 d=315 mm Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 25/30 Kollona b/a monolite C 25/30 h ~ 4m Trare e arkitrare b/a C 25/30 Soleta te plota b/a C 25/30, h~4 m Termoizolim solete 10-20 cm me polisterol kompakt Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 16/20 Mure buto betoni C 12/15 F.V. Hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm F.V. Hekur betoni periodik Ø > 12 mm Trotuar, me 6 cm beton, me lluster	21-50 milion lekë	21,214,096
NS 1	A	Punime për prishjen e ndërtimeve	Prishje soleta b/a Prishje suvatim i jashtem Prishje suvatim muri i brendshem Prishje suvatim solete (h<4m) Prishje suvatim kolona/trare (h<4m) Prishje kollona, trare b/a Prishje shtrese h/izolim tarace Prishje trotuari ekzistues Prishje shtresash ekzistuese, t=10cm. Prerje me disk (betone, mur guri)	0-20 milion lekë	4,709,096
NS 4	A	Punime rifiniture të muraturës dhe punimeve te lidhura me ato.	Torkretim me llac cimento 1: 2, t = 5 cm Hapje ne murature guri - (thyerje me matrapik dore dhe kompresor ajri per perforcimin e themelit) dhe Heqje pjese themel guri per mbjelljen e koloncinave (heqje guresh me matrapik dore dhe kompresor ajri sipas fugave dhe pergatitja per perfor. e kollonave dhe berjen e kolloncinave te reja Suvatim me llac struktural M-30 para dhe pas vendosjes se FRP pergatitja e siperfaqes per perforcim Injektim llaci strukturor (pas pastrimit te muratures se gurit ne fasade ne fugaturat e thella te murit)	0-20 milion lekë	9,197,331
NS 8	A	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.	Panele metalike per skele	0-20 milion lekë	3,888,191
NS 9	A	Punime strukturorë speciale.	Perforcim solete dhe traresh me FRP 1, prajmer bikomponent me baze rezine dhe stuko epokside (siperfaqja solete) Perforcim traresh me kemishe çeliku S275 (L75x5 perfshire pllakat dhe prixonierat M16, C15.8) Mbjellje fitilash me rezine epoksidike (ne betone) Boje kundra ndryshkut siperfaqe metalik (lyerja e hekurit	0-20 milion lekë	10,606,748

			me material kunder korrodimit) Mbjellje fitilash (L=40+30cm) me mbushje llaç çimento M10 (ne murature guri) Mbjellje fitilash D10/50cm (L=10+5cm) me mbushje llaç çimento M10 (ne murature guri) Mbjellje fitilash D8/50cm (l=5+5cm) me mbushje llaç çimento M30 (ne solete ekzistuese)		
NS 18	A	Punime topogjeodezike	Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik	0-20 milion lekë	-

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor**, si më poshtë:

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinjer Mjedisi
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

ARGUMENTIMI I STAFIT

Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe VKM nr.285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohej qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates. Kriteri per Stafin, lidhet ngushtesisht me objektin e kontrates, specifikimet teknike, raportin teknik dhe volumet e punimeve.

Nevoja per inxhinieret ne objekt eshte e diktuar nga pervoja dhe legjislacioni per punimet e ndertimit. Mungesa e ketij stafi pothuajse ne c;do rast rezulton ne realizim jashte afatit, jashte normave dhe me cilesi te dobet te objekteve.

Numri i stafit kryesor teknik eshte percaktuar nga pikepamja e natyres teknike te kontrates me qellimin per te patur nje rezultat sa me te mire ne mbarevajtjen dhe zbatimin e punimeve.

Operatoret ekonomike duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten. Drejtuesi i projektit eshte pergjegjes per ndertimin objektit ne perputhje me kushtet teknike te zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune brenda kushteve te kontrates

Per permbushjen e ketij kriteri, operatoret ekonomike duhet te vetedeklarojne disponimin e personelit kryesor ne Formularin Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet te permbaje kerkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

Punimet apo veprimtarite konkrete per te cilat kerkohet ekspertiza e tyre profesionale jane:

Inxhinier Ndërtimi	Punime gërmimi në tokë. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. Punime për prishjen e ndërtimeve. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. Punime strukturorë speciale.
Inxhinier Mekanik	Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
Inxhinier Mjedisi	Punime të inxhinierisë së mjedisit.
Inxhinier Gjeodet	Punime topogjeodezike

2.3.4. Operatori ekonomik duhet te disponoje punonjes te specializuar/te kualifikuar, si me poshte:

1(nje) punonjes te disponoje certifikate si "Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune ne perputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier". Per te deshmuar permbushjen e ketij kriteri, operatoret ekonomike duhet te paraqese:

- Diplome/certifikate
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojte prezencen ne objekt te personelit te mesiperme dhe/ose te kerkoje ndryshimin/zevendesimin e tyre me staf me kualifikime te njejta ose me te larta, ne rast konstatimi te shkeljeve te rregullave/normave perkatese. Ne rast perseritje mund te merren masa per nderprerjen e kontrates.

Kriteri konsiderohet i permbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Permbledhes te Vetedeklarimit, sipas shtojces nr. 8. Formulari i vetedeklarimit duhet te permbaje kerkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve te ankimit, i kerkon ofertuesit te kualifikuar i pari, dorezimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi 2.3.4: Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c), te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohet qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane personelin e nevojshem te kualifikuar per realizimin me sukses te kontrates.

Kerkesa e mesiperme mbeshtet ne ligjin Nr. 10327 date 18/02/2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores "Per sigurine ne kantier" si dhe ligjit Nr. 10431 date 09.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit". Natyra e kontrates dhe specifikat e sajë kerkojne njohuri e pergatitje te posacme per vleresime te perpikta per te zgjidhur ceshtje qe lidhen me garantimin e sigurise dhe mbrojtjen ne pune. Ne rreguloren per sigurine ne kantier miratuar me VKM nr.312/2010 eshte percaktuar se punedhenesi per mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet te ndjeke kurse formimi perkates ne fushen e sigurise e te shendetit ne vendin e punes. Cdo punedhenes zgjedh nje ose disa persona si pergjegjes per ndihme e pare ne rast emergjencash dhe per sigurine e mbrojtjen e shendetit. Rregullorja percakton kerkesat minimale te sigurise dhe te shendetit ne pune per kantieret e perkohshem ose te levizshem, si dhe masat e pergjithshme te mbikeqyrjes. Operatori/et ekonomik/e, qe gjate kryerjes se ushtrimit te veprimtarise, duhet te kete/ne kualifikimet dhe

dokumentat perkatese lidhur me ndikimin ne mjedis dhe rehabilitimit te mjedisit, per raste ndotjesh sic; parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e pergjithshme per garantimin e mbrojtjes ne nje nivel te larte te mjedisit jane detyrim ligjor per cdo subjekt tregtar person fizik apo juridik per parandalimin dhe pakesimin e rrezeqeve ndaj jetes e shendetit te njeriut, sigurimin dhe permiresimin e cilesise se jetes, ne dobi te brezave te sotem dhe te ardhshem, si dhe sigurimin e kushteve per zhvillimin e qendrueshem te vendit. Garantimi i ekspertizes se mbrojtjes nga cdo rrezik dhe te papritur ne pune dhe dokumentat perkatese te personave pergjegjes i sherbejne autoritetit per te krijuar bindjen dhe besueshmeri per realizimin e kontrates.

Pergjegjes per sigurine dhe mbrojtjen e shendetit ne pune rekomandohet te jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune.

2.3.5 Operatori ekonomik pjesemarres, per realizimin e punimeve objekt kontrate duhet te disponoje fuqi punetore prej **minimalisht 25 persona** per periudhen, 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave e vertetuar kjo me:

- Vertetim te leshuar nga Sigurimet shoqerore ose Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj, per periudhen 3 mujore nga momenti i hapjes se ofertave.

* Kriteri konsiderohet i permbushur me vetedeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

ARGUMENTIMI NR PUNONJESVE

Ne percaktimin e numrit te punonjesve specialisti i fushes ka bere nje analize bazuar tek faktoret, si volumet dhe kategorite e punimeve, kualifikimi i punonjesve, grafiku i punimeve, zerat e punimeve dhe oret e punes dhe pagen minimale te lejuar qe duhen per te permbushur kontratesn. Numri i punonjesve dhe qendrueshmeria e tyre ne pune me koheshtrirje (3 mujore nga momenti i hapjes, tregon besueshmeri per autoritetin qe, operatori do te permbush kontraten. Deshmia e kerkuar per numrin e fuqise punetore te operatorit ekonomik e nevojshme per ekzekutimin e objektit te kontrates, eshte dokument qe verteton kapacitetin teknik dhe profesional te operatorit, persa kohe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjesve ne regjistrin e sigurimeve eshte nje detyrim ligjor i punedhenesit e parashikuar nga Kadi i Punes, per rrjedhoje vertetimi i leshuar nga administrata tatimore e shoqeruara me listpagesat me kete koheshtrirje eshte dokument vertetues per qendrueshmerine e te punesuarve, pervojen e tyre, dhe jane ne perpjesetim me natyren dhe permasat e kontrates. Punesimi i nje numri te caktuar, pervec; besueshmerise se operatoreve ekonomik, si nje nga kerkesat themelore te kualifikimit, perpiqet te kufizojte edhe problematikate sociale dhe shmangien e informalitetit ne tregun e punes. Po ashtu eshte nje tregues i kualifikimit dhe eksperiences qe duhet te kete kjo kategori e punonjesve. Vendosja e kriterit duke perfshire dhe stafin teknik, eshte ne perputhje me volumin e punes, natyren dhe terrenin ku do te kryhen punimet. Kriteri per kualifikim eshte vendosur qe t'i sherbeje autoritetit per te njohur gjendjen e kapaciteteve te operatoreve te cilet nepermjet dokumentacionit te vertetojne se zoterojne, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshem, si dhe kapacitetet organizative, gjithcka rie funksion te realizimit me sukses te kontrates.

Analizat teknike jane bazuar ne VKM nr. 216, date 13.4.2023 "Per krijimin dhe funksionimin e sistemit te integruar perinformatizimin e manualit te cmimeve per zerat e punimeve ne ndertim" Bazuar ne kater elementet e struktures se kosos (material, punetori, makineri, transport) zeri fuqi punetore ze rreth 20% te kosos.

Total ore pune = 21,571 ore (referuar oreve te punes per cdo ze pune te preventivit)

Ore/1 dite pune = 8 ore

Total Dite pune puntori = 21,571 ore/8 ore= 2,696 dite pune

Dite pune gjithesej= 5 muaj (sipas grafikut te punimeve) * 22 dite/muaj= 110 dite pune

Numri i fuqise puntore = 2,696 dite / 110 dite = 25 puntore afersisht.

2.3.6 Operatori ekonomik pjesemarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi ose qira ose kontrate furnizimi.

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njësi	Sasia	Statusi
1	Eskavator me Goma	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
2	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 Ton	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
3	Kamioncine min 3 ton	Copë	2	Ne pronësi ose me qera
4	Autovinc	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
5	Fadroma	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
6	Autobot Uji	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
7	Autobetoniere	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
8	Autopompe	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
9	Gjenerator	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
10	Vibrator	Copë	2	Ne pronësi ose me qera
11	Betoniere min 0.5 m ³	Copë	1	Ne pronësi ose me qera
12	Matrapik	Copë	1	Ne pronësi ose me qera

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike në pronësi/qira /kontrate furnizimi, do të paraqiten këto dokumenta:

- Për mjetet në pronësi (që shënohen në regjistra publike), duhet të paraqiten;- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikatën e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vërtetimin e pagesës për taksat vjetore.
- Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vërtetimin e pagesës për taksat vjetore, kontrata e qirës së vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.
- Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet të deklarojë që të gjitha mjetet dhe pajisjet e përshkruara, do të jenë të angazhuara vetëm në këto kontrate. Mjetet të cilat rezultojnë të angazhuara në kontrata të tjera afati i zbatimit të

cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojte dhe kontrolloje disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

* Kriteri konsiderohet i përbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka te drejte te kryeje verifikimet e nevojshme mbi vertetesine e informacionit te deklaruar nga operatori ekonomik si me siper ose te kerkoje operatorit sqarime dhe dokumente mbeshtetese per keto sqarime ne perputhje me nenin 24 pika 1 te VKM nr.28 date 19.05.2021 per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik.

ARGUMENTIMI MJETET

Ne baze te pikes 4, te nenit te 77, te ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Per prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/c; dhe 6/d, te VKM nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", me ane te ketij kriteri kerkohej qe operatoret ekonomike te deshmojne qe kane fuqine minimale punetore, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, te nevojshme per ekzekutimin e objektit te prokurimit, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te përbushur kontraten.

Per te percaktuar numrin e mjeteve/makinerive te nevojshme per realizimin e kontrates, jane hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit te fushes bazuar ne VKM nr. 629, date 15.7.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, date 26.10.2018).

Nr	Emri i mjetit/pajisjes	Njësi	Sasia	Emërtimi i punimeve
1	Eskavator me Goma	Copë	1	Punime gërmimi në tokë. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada. Punime për prishjen e ndërtimeve. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese. Punime strukturorë speciale. Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
2	Kamion veteshkarkues me kapacitet mbajtës deri 20 Ton	Copë	1	
3	Kamioncine min 3 ton	Copë	2	
4	Autovinc	Copë	1	
5	Fadroma	Copë	1	
6	Autobot Uji	Copë	1	
7	Autobetoniere	Copë	1	
8	Autopompe	Copë	1	
9	Gjenerator	Copë	1	
10	Vibrator	Copë	2	
11	Betoniere min 0.5 m ³	Copë	1	
12	Matrapik	Copë	1	

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- EN-ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- EN-ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

-Projekti i zbatimit, Specifikimet teknike, raportet teknik, preventivi me zerrat e punimeve, grafiku i punimeve janë hartuar nga projektues i licencuar dhe janë pjesë e pandare e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.

ARGUMENTIMI I KRITEREVE PËRZGJEDHËS PËR KUALIFIKIM

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas rëndësisë:

- | | | |
|---|-------|----|
| 1. Çmimi | pikët | 70 |
| 2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë | pikët | 5 |
| 3. Periudha garancisë dhe mirembajtjes së punimeve civile, pajisjeve dhe fidaneve (jo më pak se 2 vjet) | pikët | 10 |
| 4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%) | pikët | 10 |
| 5. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %) | pikët | 5 |

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi

[0 - 70] pikë

Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1}	Pikët e kriterit që vlerësohet
$V_{\min k1}$	Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet
$P_{\max k1}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k1}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Aftësia organizative, kualifikimi dhe përvoja e stafit për punime specifike shtesë

[0 –5 pikë]

Operatori Ekonomik për të vlerësuar për këtë kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën të stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve dhe volumeve specifike si më poshte:

-Punime për realizimin e përforcimeve strukturore në godina civile, me sipërfaqe ndërtimi jo më pak se 2,279 m² për kontrata të kryera gjatë pesë viteve të fundit.

Formula e përlllogaritjes: $\sum VS = VS_1 + VS_2 + VS_3 + VS_4 + VS_5$

VS	<i>Volumi specifik për përlllogaritjen e kriterit</i>
$\sum VS$	<i>Shuma e volumit specifik për 1 ose disa kontrata</i>

* Ky është kriter vlerësimi dhe si i tillë operatorët ekonomik nuk do të skualifikohen por do të vlerësohen, bazuar në tipologjinë, sasinë dhe përmbushjen e kushtit të afatit 5 vjeçar, afat i cili nënkupton një periudhë të pandërprere gjatë 5 viteve kalendarike, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, kur cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës. Vlera e kontratave të mëparshme dhe specifikisht vlera e punimeve dhe volumeve të kryera të realizuara, ndikon në disa aspekte të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë, sikurse janë: i. stabiliteti financiar dhe kapaciteti; -cilësia dhe standardet; -historia e suksesit; -trajtimi i kompleksitetit Për të vlerësuar për këtë kriter operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ekonomik duhet të plotësojë minimalisht vlerën e kërkuar. Nëse kjo vlerë minimale nuk plotësohet do të konsiderohet se operatori ekonomik/bashkimi i operatorëve ka marrë “0” pikë.

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k2} = O_{k2} \times P_{\max k2} / V_{\max k2}$$

P_{k2}	Pikët e kriterit që vlerësohet
V_{maxk2}	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet (vlera më e lartë e punimeve specifike te kryera)
P_{maxk2}	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k2}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Permbushja e ketij kriteri do te provohet nepermjet situacioneve perfundimtare, aktit te kolaudimit sipas pikes 2.3.1 te Kapacitetit Teknik, dorezimit te detyrueshem te informacionit te permbledhur sipas formatit bashkelidhur (Aneks 1) dhe cdo dokumentacion provues (sipas rastit) per volumet e kerkuara (leje ndertimi, projekti etj).
Volumet specifike per kontrata te cilat nuk jane kolauduar nuk do te perfshihen ne perllogartje.

Argumentim: “Punime për realizimin e përforcimeve strukturore në godina civile, me sipërfaqe ndërtimi jo më pak se 2,279 m² për kontrata të kryera gjatë tre viteve të fundit.”

Kërkesa për realizimin e punimeve të përforcimeve strukturore në godina civile, me sipërfaqe ndërtimi jo më pak se 2,279 m², është e bazuar drejtpërdrejt në volumet dhe shtrirjen e plotë të ndërhyrjeve të parashikuara në projekt. Kjo kërkesë garanton që operatori ekonomik zotëron përvojë në realizimin e përforcimeve në objekte me shtrirje të plotë ndërtimore, si dhe aftësi për të menaxhuar kompleksitetin teknik, ndërveprimin midis elementëve strukturorë dhe kushtet e punës në ndërtesa ekzistuese, në përputhje me standardet e sigurisë dhe qëndrueshmërisë.

Kërkesa në 5 vitet e fundit siguron verifikimin e kapacitetit aktual teknik dhe organizativ të operatorit ekonomik, duke garantuar që përvoja e paraqitur reflekton gjendjen sa më reale operative, përditësimin me teknologjitë dhe standardet bashkëkohore të ndërtimit, si dhe aftësinë për realizimin e kontratës brenda afatit..

3. Periudha e garancisë dhe mirembajtjes së punimeve civile, pajisjeve dhe fidaneve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar ti zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryeje. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancisë dhe mirembajtje per punimet civile, pajisjet dhe fidanet përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$P_{k3} = O_{k3} \times P_{maxk3} / V_{maxk3}$	
P_{k3}	Pikët e kriterit që vlerësohet
V_{maxk3}	Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet
P_{maxk3}	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k3}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Kontraktori i punimeve duhet te kete parasysh se gjate periudhes se garancise dhe mirembajtjes:

Çdo fidan që nuk zë, dëmtohet, nuk jep prodhim apo nuk zhvillohet për arsye të sëmundjeve, kushteve klimatike, ose gabimeve teknike gjatë mbjelljes, trajtimit, mirembajtjes etj., do të zëvendësohet nga kontraktori pa asnjë kosto shtesë për autoritetin kontraktor.

Periudha e garancisë për çdo fidan të zëvendësuar ne periudhen e garancise se kontrates rifillon nga data e zevendesimit të tij.(kjo shoqeruar me procesverbalet perkatese te zbatuesit dhe mbikqyresit)

Për këtë kriter ofertuesi duhet te paraqese propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

4. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 10 pikë]

Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- *Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.*
- *Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:*

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k4} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë garancine sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

5. Siguria ne kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë oferten per vleren PSK ne rubriken specifike/zerin “Siguria ne kantier (Plani I Sigurise e Kordinimit ne Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, date 13.04.2023)”, ne preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur ne mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, perfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore perkatese të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të vecantë per përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndesisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e vecantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet ne Vendimin Nr. 216, datë

13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike në masën jo më pak se 3%, përllogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas percaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast **jo më pak se 1,568,964.85 leke pa tvsh**. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, Aneksi VI “Permbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zerin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. “LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 1,568,964.85 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 1,568,964.85 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 1,568,964.85 leke pa tvsh, do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përllogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilësia në punime: siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social” **nëse vlera e saj do të jetë më shumë se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilësia në punimet e kryera: siguria në kantier/shendeti impakti në mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O – (pikët e Ofertës)

M_o – Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme

N – Numri i ofertave të vlefshme

PR (R_{rm}) – Rritje e mundshme

$M_o = O_1 + O_2 + O_3 + \dots + O_n / N$

PR = 200 % M_o

Vlera e ofertave të ofruara > PR rjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përlogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK (200% MO = 51,500,000 leke < 55,000,000 leke) dhe vlerësohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlera per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlera korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të

Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Projekti teknik, Specifikimet teknike, raportet teknike, preventivi me zerat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekti projektues të licencuar dhe janë pjesë e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne kete procedure prokurimi do te pranohen edhe ekuivalent

**Gjithashtu edhe nese tek specifikimet teknike AK i është referuar vetëm standardeve europiane: “EN...”
Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane.**